

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Rasti Nr.: PKR 965/13
PPS 29/11 & 47/12

NE EMER TE POPULLIT

29 korrik 2016

Gjyqtarja e EULEX-it Katrien Gabriël Witteman, duke vepruar si Kryetare e trupit gjykues, Gjyqtarja e EULEX-it Franciska Fiser dhe Gjyqtari vendor Vesel Ismajli si anëtarë të trupit gjykues,

Në rastin penal kundër të akuzuarve:

1.

Emri dhe mbiemri:	B.M.
Emri i babait	F.
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	M.Z.
Numri personal i identifikimit	XXX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Data e lindjes	XXX
Vendlindja	XXX
Vendbanimi	XXX

2.

Emri dhe mbiemri:	L.Q.
Emri i babait	B.
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	XXX
Numri personal i identifikimit	XXX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar

Data e lindjes	XXX
Vendbanimi	XXX
Adresa	XXX

3.

Emri dhe mbiemri:	B.S.
Emri i babait	XXX
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	XXX
Numri personal i identifikimit	XXX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Data e lindjes	XXX
Vendlindja	XXX
Vendbanimi	XXX

4.

Emri dhe mbiemri:	F.S.
Emri i babait	XXX
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	XXX
Numri personal i identifikimit	XXX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Data e lindjes	XXX
Vendlindja	XXX
Vendbanimi	XXX

5.

Emri dhe mbiemri:	A.D.
Emri i babait	XXX
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	XXX

Numri personal i identifikimit	XXX
Nënshtetësia	Kosovar
Kombësia	Shqiptar
Data e lindjes	XXX
Vendlindja	XXX
Vendbanimi	XXX

6.

Emri dhe mbiemri:	A.D.
Emri i babait	XXX
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	XXX
Numri personal i identifikimit	XXX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Data e lindjes	XXX
Vendlindja	XXX
Vendbanimi	XXX

7.

Emri dhe mbiemri:	M.M
Emri i babait	XXX
Emri dhe mbiemri i nënës i vajzërisë	XXX
Numri personal i identifikimit	XXX
Kombësia	Shqiptar
Nënshtetësia	Kosovar
Data e lindjes	XXX
Vendlindja	XXX
Vendbanimi	XXX

Të cilët u akuzuan përmes aktakuzës (së përshtatur) të Maria Bamieh, Prokurore e EULEX-it në Prokurorinë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), me datë 22 gusht 2014¹ me veprat penale si në vijim:

Pika 1

Vrasja e Rëndë, në pajtim me Nenin 23 dhe 147, paragrafët 4, 9, dhe 11, të KPK-së sepse: B.M., L.Q., B.S., F.S., A.D. dhe M.M (në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe në bashkëkryerje me B.H., SH.Q.(që të dy tashmë të dënuar për të njëjtën vepër penale), po ashtu edhe me ndihmën e A.D.T në kundërshtim të Nenit 33 të KPK-së, për hakmarrje të paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, dhe duke rrezikuar me qëllim jetën e një apo më shumë personave, kanë privuar nga jeta N.M. dhe P.S. duke vendosur dhe shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes në katin përdhese të një ndërtese që ndodhet në Prishtinë, në Bulevardin Bill Clinton; në Prishtinë, më 24 shtator 2007.

Sepse

Pas një historie të gjatë të dhunës në mes të policisë në FERIZAJ, zyrtarëve policorë nga njësia ROSU dhe E.S., dhe pas vrasjes së zyrtarit policor T.R. që besohet të jetë urdhëruar nga S., Policia në FERIZAJ së bashku me zyrtarët policorë të njësisë ROSU kanë planifikuar hakmarrje kundër S. duke hedhur bombë në restorantin e tij në Prishtinë. Bari X ndodhet në Bulevardin Bill Clinton që është një zonë e dendur banimi e që ka qenë përplot me restorante dhe bare. Bomba është vendosur me datë 24 shtator e që ka qenë gjatë periudhës së muajit të Ramazanit të atij viti, dhe të gjitha baret dhe restorantet kanë qenë të hapura për njerëzit që dilnin në Syfy. Madhësia e bombës dhe vendi i vendosjes së saj, si dhe koha e shpërthimit, tregon që të dyshuarit kanë pasur për qëllim që të vrasin;

Pika 2

Tentim Vrasje e Rëndë, sipas Neneve 20, 23 dhe 147, paragrafët 4, 9, dhe 11, të KPK-së sepse: B.M., L.Q., B.S., F.S., A.D. dhe M.M në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe në bashkëkryerje me B.H. dhe SH.Q.(që të dy tashmë të dënuar për të njëjtën vepër penale), po ashtu edhe me ndihmën e A.D.T, në kundërshtim të Nenit 33 të KPK-së, për hakmarrje të paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta, dhe duke rrezikuar me qëllim jetën e një apo më shumë personave, ndërmorën masa të menjëhershme në drejtim të privimit nga jeta të XH.S., V.Z., L.N., G.S., E.N, N.H., F.B., L.K., SH.S., M.K. dhe T. T., duke

¹ Për hir të lexueshmërisë, janë korrigjuar në këtë aktgjykim gabimet e vogla në shkrim dhe gramatikore. Kuptimi nuk është ndryshuar në asnjë mënyrë.

vendosur dhe shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes në katin përdhese të një ndërtese që ndodhet në Prishtinë, në Bulevardin Bill Clinton, e cila rezultoi në plagosjen e rëndë të individëve të përmendur më lart; në Prishtinë, me datë 24 shtator 2007;

Sepse

Pas një historie të gjatë të dhunës në mes të policisë në FERIZAJ, zyrtarëve policorë nga njësia ROSU dhe E.S., dhe pas vrasjes së zyrtarit policor T.R. që besohet të jetë urdhëruar nga S., Policia në FERIZAJ së bashku me zyrtarët policorë të njësisë ROSU, kanë planifikuar hakmarrje kundër S. duke hedhur bombë në restorantin e tij në Prishtinë. Bari X. ndodhet në Bulevardin Bill Clinton që është një zonë e dendur banimi e që ka qenë përplot me restorante dhe bare. Bomba është vendosur me datë 24 shtator në ora 2:10 të mëngjesit. Kjo ka ndodhur gjatë periudhës së muajit të Ramazanit të atij viti, dhe të gjitha baret dhe restorantet kanë qenë të hapura për njerëzit që dilnin në Syfyr. Madhësia e bombës dhe vendi i vendosjes së saj si dhe koha e shpërthimit, tregon që të dyshuarit kanë pasur për qëllim që të vrasin, dhe kanë vrarë, si pasojë, N.M. dhe P.S., janë vrarë, dhe me këtë veprim ata kanë tentuar që ta vrasin XH.S , V.Z., L.N., G.S. E.N., N.H., F.B., L.K., SH.S., M. K. dhe T.K., duke vendosur dhe shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes në katin përdhese të ndërtesës ku ndodhet bari S. në Prishtinë, që rezultoi në plagosjen e rëndë të individëve të përmendur si më lart; në Prishtinë, më 24 shtator 2007;

Pika 3

Shkaktimi i Rrezikut të Përgjithshëm, sipas Neneve 23 dhe 291, paragrafët 1 dhe 5 të KPK-së, sepse: B.M., L.Q., B.S., F.S., A.D. dhe M.M në bashkëkryerje me njëri-tjetrin dhe po ashtu në bashkëkryerje me B.H. dhe SH.Q.(që të dy tashmë të dënuar për të njëjtën veprë penale), po ashtu edhe me ndihmën e A.D.T kanë shkaktuar rrezik të madh për jetën e njerëzve duke shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes që ishte vendosur në katin përdhese të një ndërtese në Bulevardin Bill Clinton në Prishtinë, që ka rezultuar në vdekjen e dy personave (N.M. dhe P.S.), lëndime të rënda trupore për njëmbëdhjetë persona (XH.S , V.Z., L.N., G.S. E.N., N.H., F.B., L.K., SH.S., M. K. dhe T.K.), dhe dëme të konsiderueshme materiale në pronën e disa aktiviteteve të biznesit (Ciko, Besa, Uran Shped, Oslo, Pasazh, Noti, Kojota, Fitness Club dhe X.); në Prishtinë, me 24 shtator 2007;

Sepse

Pas një historie të gjatë të dhunës në mes të policisë në FERIZAJ, zyrtarëve policorë nga njësia ROSU dhe E.S., dhe pas vrasjes së zyrtarit policor T.R. që besohet të jetë urdhëruar nga S., Policia në FERIZAJ, së bashku me zyrtarët policorë të njësisë ROSU kanë planifikuar hakmarrje kundër S.. Ata e kanë përpiluar një plan dhe janë takuar në Fermën e Deleve në Rakaj me datë 23 shtator rreth orës 22:00. Nga

Rakaj, dy persona janë dërguar për të marrë mjete shpërthyes, një minë anti-tank dhe armë, domethënë dy armë MP5. Plani ishte për ta bombarduar restorantin X. në Prishtinë. Pas kthimit të tyre, një bombë ishte vendosur, përkatësisht një minë anti-tank, me eksplozivë dhe siguresat. A.D., B.M. dhe M.M janë udhëzuar se çfarë të bënin. D. pastaj është larguar nga Policia për ta ekzekutuar planin dhe i ka pritur ata në barin EUROPA 92 në Kaçanik. Dy makina të policisë janë siguruar nga B.S. dhe F.S.; numrat e targave ishin fshehur nga B.M.. Grupi pastaj janë futur në makina dhe kanë shkuar në Prishtinë për ta ekzekutuar planin. Lokali-bari X. ndodhet në Bulevardin Bill Clinton që është një zonë e dendur banimi dhe që ka pasur plot restorante dhe bare. Bomba është vendosur me datë 24 shtator rreth orës 2:10 të mëngjesit. Kjo ka ndodhur gjatë periudhës së muajit të Ramazanit të atij viti, dhe të gjitha baret dhe restorantet kanë qenë të hapura për njerëzit që dilnin në Syfyr. Madhësia e bombës dhe vendi i vendosjes së saj si dhe koha e shpërthimit, tregon që të dyshuarit kanë pasur për qëllim që të vrasin dhe të shkaktojnë rrezik për persona dhe pronat. Pasojat e veprimeve të tyre kriminele ishin se N.M. dhe P. S. janë vrarë, dhe me këtë veprim kriminal ata kanë tentuar që ta vrasin X.H.S , V.Z., L.N., G.S. E.N., N.H., F.B., L.K., SH.S., M. K. dhe T.K, duke vendosur dhe shpërthyer një mjet të improvizuar shpërthyes që ishte vendosur në katin përdhese të një ndërtese në Bulevardin Bill Clinton në Prishtinë, që ka rezultuar në plagosjen e rëndë të individëve të përmendur më sipër, dhe dëme të konsiderueshme materiale në pronën e disa aktiviteteve të biznesit (Ciko, Besa, Uran Shped, Oslo, Pasazh, Noti, Kojota, Fitness Club dhe X.); në Prishtinë, me 24 shtator 2007,

Pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, i cili u mbajt në fillim para një trupi gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it Anna Adamska-Gallant, Kryetari i trupit gjykues dhe Gjyqtari i EULEX-it Malcolm Simmons si dhe Gjyqtari vendor Vesel Ismajli, anëtarë të trupit gjykues, në shqyrtimet gjyqësore të mbajtura me datë 11 korrik, 25, 26 dhe 27 gusht 2014, 2, 3, 4, 23, 24 dhe 25 shtator, 7, 13, 14 tetor, 14 dhe 25 nëntor 2014 (të gjitha të hapura për publik) dhe seancat dëgjimore në pajtim me Nenin 291 Par. 2 i KPP-së me datë 16 dhjetor 2014, 30 janar, 27 shkurt 2015 dhe 20 tetor 2015; në të cilat seanca kanë qenë të pranishëm edhe Prokurori edhe të pandehurit me avokatët e tyre mbrojtës, dhe pasi që shqyrtimi kryesor ka filluar që nga fillimi sipas Nenit 311 paragrafi 3 i Kodit të Procedurës Penale të Republikës së Kosovës² (KPP) para trup gjykues te tanishëm në seancat gjyqësore publike me datë 14 prill 2016 dhe 6, 22, 28 dhe 29 korrik 2016, në prani të Prokurorit, të pandehurve dhe avokatëve mbrojtës;

Pas këshillimit dhe votimit në bazë të Nenit 357 të KPP-së me datë 28 korrik 2016,

² Ligji Nr. 04/L-123

Në bazë të Neneve 362, 363, 366, 450, 454 dhe 463 të KPP-së,

Merr këtë:

AKTGJYKIM

Në bazë të Nenit 363, Paragrafi 1, Nën-paragrafi 1.3 i KPP-së

- 1. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit B.M., refuzohen.**
- 2. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit L.Q., refuzohen.**
- 3. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit B.S., refuzohen.**
- 4. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit F.S., refuzohen.**
- 5. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit A.D., refuzohen.**
- 6. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit M.M, refuzohen.**
- 7. Akuzat e Prokurorit të PSRK-së nën Pikat 1, 2 dhe 3 të dhënies së ndihmës në kryerjen e vrasjes së rëndë, tentim vrasjes së rëndë dhe shkaktimit të rrezikut të përgjithshëm, kundër të pandehurit A.D., refuzohen.**

8. Palët e dëmtuara udhëzohen që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojnë në kontest civil;
9. Shpenzimet e procedurës do të paguhen nga mjetet buxhetore.

ARSYETIMI

Sfondi procedural

1. Në mëngjesin e hershëm të datës 24 shtator 2007, një bombë shpërtheu në ambientet e lokalit X në Bulevardin Bill Clinton në Prishtinë. Si rezultat, dy persona janë vrarë dhe disa të tjerë janë plagosur.

Rasti i Shpërthimit me Bombë Bill Clinton I³ (në tekstin e mëtejme: RSHBBK1)

2. Të gjithë të dyshuarit e listuar në aktakuzë, që kanë shpënë tek këto procedura aktuale, janë hetuar në vitin 2007, pasi që Policia kishte dyshimin e bazuar se ata të gjithë kanë qenë të përfshirë në rastin e shpërthimit me bombë.⁴ Me datë 8 tetor 2007, Prokurorja e EULEX-it Znj. Maria Bamieh (në tekstin e mëtejme: Prokurorja Bamieh) ka lëshuar një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve kundër personave të dyshuar atëherë: **L.Q.**, **B.S.**, B.H., A.B., B.SH. dhe SH. H. Me datë 28 janar 2008, ajo ka lëshuar një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve kundër SH.Q. dhe N.C.. Me datë 14 mars 2008, ajo ka lëshuar një Aktvendim tjetër mbi fillimin e hetimeve kundër F. H., **B.M.**, A. A. dhe **F.S.**, që është ndjekur më pas nga një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve kundër A.A., me datë 9 qershor 2008.⁵
3. Me datë 12 gusht 2008, Prokurorja Bamieh ka ngritur një aktakuzë kundër B.H.t, SH.Q. dhe N.C. në të cilën ajo i akuzoi ata me krime që kishin të bëjnë me rastin e shpërthimit me bombë. Të dyshuarit e tjerë të përmendur më sipër nën pikën 2 nuk ishin akuzuar ‘pasi që nuk kishte prova të mjaftueshme’⁶. Prokurorja nuk ka lëshuar ndonjë vendim formal për ndërprerjen e hetimeve ndaj tyre.⁷

³ Rasti P Nr. 488/08

⁴ Aktakuza me datë 22 gusht 2014, faqe 5, nën A.1

⁵ Dosja e prokurorisë 39, pikat 4, 3, 2 dhe 1 përkatësisht

⁶ Aktakuza e datës 22 gusht 2014, faqe 5, nën A.3

⁷ Aktvendimi i Kryetarit të trupit gjykues mbi Kundërshtimet ndaj Provave dhe Kërkesës për të hedhur poshtë aktakuzën, me datë 21 mars 2014, par. 85

4. Gjatë shqyrtimit kryesor të rastit RSHBBK1, që të tre të pandehurit janë deklaruar të pafajshëm. Me aktgjykimin e datës 22 shtator 2009, N.C. është liruar dhe dy të pandehurit e tjerë u dënuan me 25 vjet burgim. Ky aktgjykim u la në fuqi nga Gjykata Supreme si gjykatë e Shkallës së Dytë, në aktgjykimin e saj të datës 25 maj 2012, dhe Ankesat e të pandehurve u hodhën poshtë përfundimisht nga një aktgjykim i Gjykatës Supreme si shkallë e tretë me datë 16 janar 2013. Kërkesa për mbrojtjen e ligjshmërisë e parashtruar nga avokati mbrojtës i B.H., është hedhur poshtë nga e njëjta Gjykatë Supreme me aktgjykimin e datës 5 shkurt 2014, duke pasur edhe mbështetjen e mendimit të Prokurores së PSRK-së .

Rasti i Shpërthimit me Bombë Bill Clinton 2 (RSHBBK2)

5. Me datë 7 shkurt 2011, M.Q., vëllai i SH.Q., është paraqitur para Prokurores Bamieh, duke deklaruar se ai kishte informacione të rëndësishme në lidhje me rastin e shpërthimit me bombë.⁸
6. Deklarata e dëshmitarit M.Q. u bë shkak për hetime të reja, nisur zyrtarisht me aktvendim mbi fillimin e hetimeve të datës 30 mars 2011 (me rastin numër PPS 29/11) kundër të dyshuarve B.M., F.S. dhe B.S., zgjeruar me datë 10 maj 2012 për të përfshirë edhe të pandehurit L.Q., **A.D.** dhe **M.M.**⁹
7. Me datë 30 qershor 2011, Prokurorja Bamieh e mori në pyetje SH.Q. në cilësinë e dëshmitarit. Procesverbali i dëgjimit të dëshmitarit përmban si në vijim:

“SH.Q.: para se të fillojmë, para se ta japi këtë deklaratë unë jam këtu për të bashkëpunuar, të gjitha ato që unë jam gati t’i them do të provohen nga provat që keni këtu. Një tjetër gjë është se për momentin unë jam duke e ndarë qelinë me B.H.. Avokati i tij është shumë i interesuar që ta ketë deklaratën time, por unë do të doja që ajo të qëndrojë sekrete derisa gjyqtari ta marrë vendimin e tij në lidhje me mua si dëshmitar bashkëpunues. Ne mund të fillojmë.”¹⁰

Më pas, SH.Q. dhe B.H. kanë dhënë disa deklarata dëshmitarësh para prokurores Bamieh dhe/ose hetuesve të Njësisë Policore të EULEX-it për Hetimin e Krimit të Organizuar (OCIU), në të cilat ata kanë pranuar të kenë marrë pjesë në sulmin me bombë duke i spikatur të pandehurit e tanishëm si bashkë kryes.

⁸ CD verbatim, Shtojca 13 në letren e prokurorëve të shtetit WENDORF dhe H., me datë 8 prill 2015 fq. 15 ff

⁹ Dosja e prokurorisë 1, fq. 17-19

¹⁰ Procesverbal i dëgjimit të dëshmitarit në një hetim me datë 30 qershor 2011, Dosja e prokurorisë 13, faqe 1

8. Me datë 13 prill 2012, Prokurorja Bamieh ka parashtruar në Gjykatë një kërkesë për ta shpallur SH.Q. Dëshmitar Bashkëpunues.¹¹ Menjëherë pas kësaj, me datë 23 prill 2012, ajo e tërhoqi kërkesën.¹²
9. Me datë 14 maj 2012, Prokurorja Bamieh ka lëshuar një Aktvendim mbi fillimin e hetimeve (me numër PPS 47/12) për veprën penale të Krimit të Organizuar kundër të pandehurve të dhënë nën numrin 6., bazuar në të njëjtat fakte si akuzat e tjera nën hetim.¹³ Pas disa vazhdimëve, që të dyja hetimet 29/11 dhe 47/12 do të përfundonin me datë 30 shtator 2013.
10. Me datë 10 korrik 2013, Prokurorja Bamieh lëshoi një Aktvendim mbi zgjerimin e hetimeve për ti përfshirë N.C. dhe **A.D.** si të pandehur. Në arsyetimin e saj ajo përmendi se “Në rastin konkret, dyshimi i bazuar kundër të gjithë të pandehurve ka lindur kryesisht nga deklaratat e dëshmitarëve SH.Q. dhe B.H. së bashku me konfirmimin nga regjistrimet, SMS-ët dhe vendndodhjen e antenave të celularëve.”¹⁴
11. Dy aktakuza të veçanta janë parashtruar në Gjykatë me datë 30 shtator 2013 (kundër të pandehurve N.C., A.D., B.M., L.Q., B.S. dhe F.S.) dhe me datë 13 dhjetor 2013 (kundër të pandehurve M.M dhe A.D.) përkatësisht. Me Aktvendimin e Kryetarit të trupit gjykues të datës 20 shkurt 2014, të dyja rastet ishin bashkuar.
12. Në aktvendimin e datës 21 mars 2014, Kryetarja e atëhershme e trupit gjykues e ka hedhur poshtë aktakuzën kundër të pandehurit N.C. Ajo gjithashtu i hodhi poshtë akuzat për krim të organizuar dhe bashkim kriminal kundër të pandehurve të mbetur, dhe shkaktimi i rrezikut të përgjithshëm kundër A.D.t, duke konfirmuar akuzat e Vrasjes së Rëndë, Tentim Vrasjes së Rëndë dhe Shkaktimit të Rrezikut të Përgjithshëm kundër të pandehurve, me përjashtim të A.D. dhe Ndihma e dhënë në kryerjen e veprës penale kundër këtij të fundit. Kryetarja e trupit gjykues i hodhi poshtë kundërshtimet ndaj provave dhe mocionet në lidhje me aktakuzën si të pabazuar. Aktvendimi është konfirmuar nga Gjykata e Apelit në aktvendimin e saj të datës 22 maj 2014.
13. Me datë 11 korrik 2014, është mbajtur seanca e parë dëgjimore. Që të gjithë të pandehurit u deklaruan të pafajshëm në lidhje me akuzat.
14. Me 22 gusht 2014, Prokurorja Bamieh e ka parashtruar një aktakuzë të përshtatur me vendimin e Gjykatës Supreme. Mbi besueshmërinë e tregimit të SH.Q. dhe B.H. në përgjithësi, Aktakuza pohon si në vijim .

¹¹ Dosja e prokurorisë 1, fq. 40-44

¹² Dosja e prokurorisë 1, fq. 44/1

¹³ Dosja e prokurorisë 1, fq. 67-80

¹⁴ Aktvendimi i prokurores mbi zgjerimin e hetimeve I datës 10 qershor 2013, faqe 2 nga 15

B.H. dhe SH.Q. ishin në dy reparte të ndryshme të burgut të Dubravës dhe nuk kanë pasur kontakt me njëri tjetrin, ashtu si deri në kohën kur B.H. e bëri deklaratën e tij.

15. Në tetor të vitit 2014, Prokurorja Bamieh e ka lëshuar misionin. Rasti RSHBBK2 qe transferuar tek Prokurori Kent Mortimore, ndërsa dy prokurorë special, Prokurori i EULEX-it Heikki Wendorf dhe Prokurori i Shtetit i Kosovës A.H., ishin caktuar për të hetuar (më tej) pretendimet e ngritura nga familjet H. dhe Q. për dhënien e ryshfetit, në intervistat e tyre me Prokuroren Bamieh dhe OCIU (NJHKO). Këtyre hetimeve më vonë i qe dhënë numri PPS Nr. 24/2015 dhe qenë emëruar ‘Hermes’ (në tekstin e mëtejshëm: rasti Hermes).
16. Me datë 25 nëntor 2014, gjatë shqyrtimit gjyqësor, Prokurori i EULEX-it Kent Mortimore tha në gjykatë si në vijim.

“Siç e di gjykata, unë jam caktuar [për]në këtë rast afërsisht rreth dy javë më parë. Që nga ajo kohë unë kam qenë duke shqyrtuar dosjet dhe kam bërë përgatitjet për të vazhduar këtë gjykim dhe ndoshta më e rëndësishmja - për të siguruar që është bërë zbulimi i tërësishëm i informatave për të pandehurit. Ashtu siç unë do e përshkruaj në dy minutat e ardhshme, mua më është bërë e qartë se zbulimi i plotë nuk është bërë. (...)

Në fillim të nëntorit kam zbuluar dy dosje me material që e mbajnë këtë numër të rastit. Këto dosje qenë gjetur në zyrën e personit që ishte duke e ndjekur penalisht këtë rast më parë. Z. Hardaway dhe unë, i kemi shqyrtuar me kujdes ato materiale. Ato qenë dosje me fjalën ‘Ghost’ (fantazmë) të shkruar në to. Ato përfshinin intervistat me dëshmitarët e mundshëm në këtë rast, intervistat me dëshmitarë aktual të emëruar në këtë rast dhe materialet që sugjeronin motivin e mundshëm të dëshmitarëve për të dhënë dëshmi të rrejshme. Kah fundi i javës së kaluar ne kemi konfirmuar se këto materiale nuk u janë dhënë të pandehurve. Unë menjëherë kam urdhëruar që këto materiale të përkthehen në gjuhën shqipe. Sapo që kjo të ndodhi, unë do të ia zbuloj këto materiale Gjykatës dhe avokatëve mbrojtës të të pandehurve. Përveç kësaj, unë kam zbuluar incizime në video që përshkruajnë rekonstruimin e vendit të ngjarjes nga Z. Q. dhe Z. H.. Këto janë prezantuar si deklaratatë të dëshmitarëve dhe ato nuk u janë shpalosur avokatëve mbrojtës. Këto janë materialet për të cilat ne kemi dijeni.

Unë kam besim të plotë se materiale tjera shtesë relevante ekzistojnë të cilat nuk i janë shpalosur kësaj Gjykate ose avokatëve mbrojtës të të pandehurve. Këtu është baza e besimit tim të fortë: Unë kam përcaktuar se prokurorja e mëparshme dhe një tjetër prokuror, e kanë përdorur këtë rast si një mjet për të hetuar akuzat për ryshfet dhe korrupsion. Ai hetim ishte absolutisht i lidhur me këtë rast. Unë besoj se dokumentet lidhur me atë pjesë të hetimeve janë në posedim të një prokurori të EULEX-it dhe një prokurori vendor. Unë nuk i kam parë ato dokumente e as Z. Hardaway. Unë i kam kërkuar këto dokumente me anë të një letre nga prokurori.

(...)

Pas shqyrtimit të dosjeve “Ghost”(Fantazma), ne jemi të mendimit se këto dokumente sugjerojnë fort ekzistencën e materialit shtesë të regjistruar dhe ka të ngjarë që të ketë

*raporte hetimore. Bazuar në atë që unë kam përshkruar, është e qartë se zbulimi i plotë nuk është bërë për të pandehurit në këtë rast (...). Për fat të keq ne nuk jemi në gjendje për të raportuar për ekzistimin apo mosekzistimin e dokumenteve të tjera që do të thotë se unë nuk mund të ia them gjykatës sasinë e materialeve të cilat nuk janë shpalosur. Ne jemi aktivisht duke e kryer një hetim për të iu përgjigjur këtyre pyetjeve. Por ne besojmë se do të ishte haptazi e padrejtë për të vazhduar me këtë gjykim derisa ai hetim të përfundojë.*¹⁵

17. Më 27 shkurt 2015, për shkak se përpjekjet e tij kishin dështuar, Prokurori Mortimer ka parashtruar një kërkesë (të pa datë)¹⁶ duke kërkuar nga Gjykata që të nxjerrë një urdhër për ti dhënë atij qasje në të gjitha materialet për të përcaktuar nëse ato përmbajnë prova 'relevante dhe/ose dëshmi shfajësuese në kontekstin e rastit RSHBBK2 '. Prokurori gjithashtu kërkoi leje për të ekzaminuar përmbajtjen e kutisë së e-mailave të Znj. Bamieh dhe për të rikthyer çdo dosje të fshirë. Kërkesa thotë si në vijim.

*“Më 12 nëntor 2014, prokurori i poshtë-nënshkruar u takua me Prokurorin Wendorf në zyrën e tij. Gjatë atij takimi, Z. Wendorf ka konfirmuar faktet e mëposhtme. Ai përdori aktvendimin për fillimin e hetimeve në rastin e RSHBBK-II, si autoritetin e tij për kryerjen e hetimeve të tjera përgjatë të paktën muajit mars të vitit 2014. (...) Ai kishte marrë vetëm së fundi numrat e rasteve të cilat nuk kanë të bëjnë me RSHBBK- II. (...)”*¹⁷

18. Më 31 mars 2015, Gjykata ka lëshuar një urdhër me të cilën kërkesa e prokurorit është aprovuar pjesërisht. Prokurorët e PSRK-së Wendorf dhe Hamiti u urdhëruan për të dorëzuar të gjitha materialet e dokumentuara apo materialet e tjera që ishin në mbajtje, kontroll apo posedim të tyre, të rëndësishme apo të lidhura në çfarëdo mënyre me rastet numër PPS 29/11 dhe 47/12, duke përfshirë materiale të tilla të dokumentuara apo materiale të tjera që kanë të bëjnë me cilindo nga të pandehurit e këtij rasti dhe të gjitha materialet e tjera që ishin në mbajtje, kontroll apo posedim të tyre që përmbajnë informacione në lidhje me të dyja rastet e shpërthimit me bombë në Bill Klinton.
19. Më 8 prill 2015, në përgjigje të urdhrin të gjykatës, prokurorët Wendorf dhe Hamiti kanë dorëzuar një letër me 13 shtojca, duke përfshirë një CD-Rom. Në letrën e tyre shoqëruese mund të lexohet kjo si në vijim.

“Ne jemi të befasuar për të parë se kërkuesi, Prokurori i EULEX-it i PSRK-së Z. Kent Mortimore, e ka mashtruar gjykatën duke sugjeruar se letra jonë që i ishte dërguar atij me datë 20.11.2014 ishte e pavërtetë dhe pretendonte se ne kishim refuzuar që të ia dorëzojmë atij të gjitha provat shfajësuese në lidhje me rastin e tij.” (...)”Ne nuk kemi asnjë dëshmi goftë fajësuese ose shfajësuese, në lidhje me të pandehurit e mëposhtëm: M.M, B.M., B.S.,

¹⁵ Procesverbal nga shqyrtimi gjyqësor i datës 25 nëntor 2014

¹⁶ Procesverbal nga shqyrtimi gjyqësor i datës 27 shkurt 2015

¹⁷ faqet 4-5 të mocionit të prokurorit të PSRK-së, pranuar me 27 shkurt 2015

F.S., A.D. dhe L.Q.. Në fakt këto emra nuk paraqiten fare në materialet tona të provave. Emri A.D. paraqitet në nëntë intervista të kryera në kuadrin e hetimit tonë (...),por përsëri ato prova nuk janë as fajësuese e as shfajësuese vis-à-vis shpërthimi me bombë që ndodhi me datë 24.09.2007. (...)Së fundi, ne jemi me këtë duke e njoftuar gjykatën se asnjëri prej nesh, as Prokurori i EULEX-it Heikki WENDORF dhe/ose Prokurori i Shtetit i Kosovës Armend Hamiti, nuk kemi ndërmarrë ndonjë veprim hetimor duke e përdorur autoritetin e rastit ekzistues të njohur si "Shpërthimi me Bombë Klinton II". Ne mund të konfirmojmë se ne kemi në posedimin tonë kopjet e materialeve provuese që mbajnë numrat e rastit PPS 29/11 & 47/12 dhe PPN 29/2011; ashtu siq e dimë ne, ato prova janë mbledhur nga ish-Prokurorja e EULEX-it e PSRK-së Maria BAMIEH ose nga zyrtarët policorë të autorizuar nga ajo, dhe tek më vonë janë ndarë me ne. Normalisht që kërkuesi është dashur që ti ketë këto materiale provuese në posedimin e tij. Megjithatë, ne jemi tani duke i dërguar përsëri kopjet e kopjeve tona për tu ri-paraqitur në dosjen e rastit të kërkuesit. Ju lutem që të vini re se ne kurrë nuk kemi pasur në posedim tonë versionin origjinal të materialeve provuese të shënuara si PPN 29/11, PPS 29/11 dhe 47/12 dhe nuk e dimë ku janë materialet origjinale."

Edhe pse kjo nuk mund të përcaktohet, Gjykata supozon se CD-Rom'i përmban versionin elektronik të "dy dosjeve me fjalën 'Ghost' të shkruar mbi to" që është përmendur nga prokurori Mortimore.. dosja pdf në CD-Rom numëron 435 faqe dhe përbëhet nga deklaratat e dëshmitarëve, me sa duket të mbledhura nga Prokurorja BamieH gjatë hetimeve të saja nën numrat PPS 29/11 dhe 47/12. Letra e datës 8 prill 2015 duke përfshirë edhe shtojcat e saja, ishte ndarë me mbrojtjen. Megjithatë, dokumentet në CD-Rom janë të gjitha (me përjashtim të dy prej tyre) në gjuhën angleze dhe nuk ishin – sipas dijenisë së Gjykatës – asnjëherë të përkthyer në shqip. Deklaratat e dëshmitarëve, shumica e tyre nga Sh.Q., B.H. dhe të afërmit e tyre, datojnë nga data 7 shkurt 2011, gjer në 21 gusht të vitit 2013. Në deklaratat e tyre, dëshmitarët iu referohen ryshfetit, duke pretenduar dhe përfshire *inter alias* kryetarin e trupit gjykues dhe njërin nga anëtarët e trupit gjykues nga gjykimi i rastit RSHBBK1.¹⁸

20. Përgjatë vitit 2015, Prokurori Wendorf e ka lëshuar misionin për arsye të cilat nuk i janë të njohura gjykatës.
21. Gjatë shqyrtimit kryesor me datë 20 tetor 2015, trupi gjykues i njoftoi palët se urdhri nuk është ekzekutuar siq duhet nga Prokurori i PSRK-së, dhe i dha Prokurorit Flynn " 21 ditë finale" për të qenë në përputhje me urdhrin.¹⁹
22. Më 24 nëntor të vitit 2015, Prokurori i EULEX-it i PSRK-së Andrew Hughes dhe Prokurori i PSRK-së Haki Gecaj kanë dorëzuar një CD-Rom që përmban një kopje të dosjes së lëndës PPS 24/2015 (rasti Hermes), dhe "të gjitha materialet e provave me numrat PPS 29/11 dhe 47/12 dhe

¹⁸ CD verbatim, shtojca 13 e letres për Prokurorët e Shtetit Wendorf dhe Hamiti me datë 8 prill 2015

¹⁹ Procesverbal nga shqyrtimi kryesor i datës 27 shkurt 2015

PPN 29/2011 në posedimin tonë ". Në letrën e tyre shoqëruese, prokurorët kërkojnë nga Gjykata "të marri në konsideratë mundësinë e rishikimit të përmbajtjes së çdo pjese të provave para vendimit për të ia zbuluar ato të pandehurve, **dhe pastaj të ia zbulojë mbrojtjes vetëm ato materiale që konsiderohen të jenë të rëndësishme për rastin PPS 29/2011**". CD-Rom'i nuk është ndarë me mbrojtjen. Ajo përmban 18 dosje, të etiketuara 'dosja 1' deri në 'dosjen 18'. Në dosjen 'dosja 15' mund të gjendet një intervistë e datës 2 korrik 2014 (dokumenti 004 dhe 005) me [A], vëllain e SH.Q., i cili thekson (dokumenti 005, f. 2/63):

“Q: Përveç informacionit të dhënë nga [X] a e dini se kush tjetër ka mbledhur para për mito-dhënësit prej nga, kush dhe si paratë janë mbledhur?”

A: Unë nuk mund të ua sigurojë ju këtë, unë nuk e di askënd tjetër përveç [X] në mbledhjen e parave, unë nuk e di se sa është e rëndësishme që një zyrtar policor në Ferizaj, dhe unë e kuptoj që kjo është më shumë një mashtrim që ai shkoj tek një shok i Sh. dhe unë mendoj se ai ia ka arritur të marrë nga ky djalë 5.000 Euro duke pretenduar se këto para ishin të nevojshme për avokatët mbrojtës, në fakt ne nuk kishim nevojë për para për avokatët mbrojtës, sepse unë jam marrë personalisht me pagesën e avokatëve mbrojtës, por këtë e kam kuptuar se ai i mori këto para dhe shkoj, kjo ka ndodhur më parë dhe unë nuk mendoj se kjo është e rëndësishme, dhe a duhet djali që u mashtrua të mendoj se ai mund të vijë dhe të paraqesë një raport, emri i zyrtarit policor është [Z].”

Z është njëri nga të pandehurit në rastin e tanishëm.

Dosja 15 më tej përmban një intervistë të dëshmitarit me një ish-zyrtar ligjor në kuadër të Zyrës së PSRK-së, e datës 7 tetor 2014 (Dok. 009, fq. 7/12), ku dëshmitari thekson:

“Unë gjithashtu kam shkuar në burgun e Dubravës me dy hetues të NJHKO-së(OCIU) për të diskutuar provat nga vendndodhja e antenave të celularit në rastin e shpërthimit të bombës në Klinton me Sh.Q., të cilat Maria [Bamieh] tashmë ia kishte dhënë atij”.

Gjithashtu në Dosjen 15 (dokumentet 005 dhe 006), mund të gjendet një intervistë e datës 17 shtator 2014 me ish-prokuroren Bamieh si dëshmitare. Në faqen 13 të kësaj interviste, ajo thotë si në vijim:

“Q: Ju përmendet se gjatë hetimit të rastit Bill Klintonit 2 hetuesit (...) kanë filluar të bashkëpunojnë me B.H. dhe po ashtu me të afërmit e familjeve Q. dhe H.. Para së gjithash a mund të ju kujtohet se kur përafërsisht ka filluar ky bashkëpunim?”

A: Është e vështirë, unë e kam pasur një dëshmitar, disa prova nga antena e celularit dhe sinqerisht kam menduar se rasti nuk kishte për ta parë aktakuzën dhe aktakuza ishte ngritur më 30 shtator 2013 dhe B. ka filluar të bashkëpunojë ndoshta një ose dy muaj para aktakuzës, dhe unë besoj se ishte qershor ose korrik, kur unë e kam marrë një deklaratë të dëshmitarit bashkëpunues prej tij (...).”

23. Me urdhrin e datës 17 dhjetor 2015 Kryetari i atëhershëm i trupit gjykues urdhëroi që 'prokurori i PSRK-së i caktuar për rastin' (a) të analizojë materialet e rastit PPS 24/2015-CD-Rom, të dorëzuara në gjykatë më 24 nëntor 2015 dhe (b) 'për të identifikuar të gjithë materialin që ishte nën kontrollin e tyre, ose në posedim të tyre që është mbledhur si rezultat i veprimeve hetimore në rastin me numër PPS 29/11 dhe PPS 47/12 dhe që përmban informacione në lidhje me të dy rastet e shpërthimit të bombës në Klinton'.
24. Më 14 prill 2016, seanca e parë u mbajt para një paneli të ri gjykues, i cili në bazë të Nenit 313, paragrafi 3, i KPP-së ka filluar shqyrtimin gjyqësor nga fillimi. Palët megjithatë ranë dakord të marrin në konsideratë të gjitha dokumentet e paraqitura që nga fillimi i shqyrtimit gjyqësor në vitin 2014, si të ri-paraqitura, dhe ti shtojnë procesverbalet e seancave të mëparshme në shkresat e lëndës. Të pandehurit u deklaruan përsëri jo fajtor për akuzat. Gjatë seancës, Prokurori Kucharski gojarisht iu përgjigj urdhrin të datës 17 dhjetor 2015 si në vijim.

*Nga data 22 dhjetor 2015 e në vazhdim, prokuroria e ka kontrolluar këtë CD me materialet në të, dhe zbuloi se ajo NUK përmban asnjë dëshmi shfajësuese kundër të pandehurve në këtë sallë gjyqi. (...) Prokuroria i ka konsideruar edhe provat fajësuese edhe provat shfajësuese duke përfshirë edhe ato të dorëzuara me 24 nëntor 2015 me CD-në e përmendur më parë, dhe nuk ka mundur që të gjejë ASNJË provë shfajësuese që do të lironte ndonjërin nga të pandehurit nga përgjegjësia e tyre kriminale(...) Ne nuk e dimë se përse parashtresa e datës 25 nëntor 2014 qe bërë nga prokurori i mëparshëm. Ndoshta sepse ka qenë ndonjë lloj strategjie akuzuese. Pas ekzaminimit të materialit, ne kemi konstatuar se nuk ka prova shfajësuese, asnjë provë të prekshme, që tregon se akuzat e paraqitura dhe veprat e përshkruara në aktakuzën që është lexuar sot, të mos jetë kryer nga këta të pandehur. Prandaj, ne e kemi zbatuar urdhrin e gjykatës me datë 17 dhjetor 2015 (...).*²⁰

25. Më 15 prill 2016, Kryetarja aktuale e trupit gjykues i shkroi një letër gjyqtarit të procedurës paraprake të caktuar për rastin e Hermes duke i kërkuar atij që ta informojë atë mbi datën kur pritet që hetimet të përfundojnë (ose ndërpriten).Gjyqtari në detyrë i procedurës paraprake u përgjigj me një letër të datës 18 prill 2016 duke e informuar Gjykatën se, sipas prokurorit të rastit, koha e supozuar e përfundimit të hetimeve ka qenë nëntor 2016, dhe se prokurori mund të kenë nevojë deri në dhjetor të vitit 2016 për të përfunduar hetimin.
26. Më 19 prill 2016, Kryetari i trupit gjykues i dërgoi një letër Prokurorit në rastin Hermes në mënyrë të drejtpërdrejtë duke i kërkuar atij për të komentuar mbi opsionet e mëposhtme: (A)për të ia zbuluar të pandehurve përmbajtjen e CD-ROM 'it, menjëherë; (B)për ta zbuluar versionin e redaktuar të CD-ROM 'it, menjëherë; (C) një zbulim të plotë pas përfundimit/ ndërprerjes së

²⁰ Procesverbal nga shqyrtimi kryesor i datës 14 prill 2016

hetimeve; (D) zbulimin e versionit të redaktuar të CD-ROM 'it pas përfundimit/ndërprerjes së hetimeve.

27. Më 21 prill 2016, prokurorët në rastin Hermes i janë përgjigjur letrës, duke thënë se "duke pasur parasysh kompleksitetin dhe ndjeshmërinë e rastit Hermes, duke përfshirë edhe masat e fshehta hetimore në vazhdim e sipër, ka gjasa reale se zbulimi i këtyre materialeve dëshmuese do të rrezikojë qëllimin e hetimit dhe madje edhe jetën ose shëndetin e njerëzve'.
28. Më 28 prill 2016, Kryetari i trupit gjykues i dërgoi një letër Prokurorit në rastin e tanishëm, duke i dhënë atij një afat përfundimtar prej 14 ditësh, duke filluar nga dita e dorëzimit të letrës, për të ekzekutuar aktvendimin e gjykatës të datës 17 dhjetor 2015.
29. Prokurori u përgjigj me letrën e datës 12 maj 2016 duke thënë sërish se ai e kishte analizuar CD-ROM 'in dhe nuk kishte gjetur asnjë material (përkatesisht prova shfajësuese) relevante për rastin.

Gjetjet e Gjykatës

Korniza Ligjore

30. Paneli do të vlerësojë nëse ngjarjet e lartpërmendura nën 'sfondin procedural 'përputhen me rrethanat të cilat do e pengonin vazhdimin e procedurës dhe hyrjen në fazën e provave.
31. Në bazë të Nenit 363, paragrafi 1, i KPP-së²¹ Gjykata do e lëshoj një aktgjykim duke refuzuar akuzat, nëse (...) 1.3. afati i parashkrimit ka skaduar, nëse një amnisti ose falje mbulon aktin, ose nëse ekzistojnë rrethana të tjera të cilat e ndalojnë ndjekjen penale.
32. Neni 7 (Detyrimi i përgjithshëm për vërtetimin e plotë dhe të saktë të fakteve) Paragrafi 2 i KPP-së, thotë:

Sipas dispozitave të parapara me këtë Kod, gjykata, prokurori i shtetit dhe policia që marrin pjesë në procedurë penale detyrohen që me vëmendje dhe me përkushtim maksimal profesional dhe me përkujdesje të njëjtë të vërtetojnë faktet kundër të pandehurit si dhe ato në favor të tij, dhe para fillimit të procedurës dhe gjatë zhvillimit të saj t'i mundësojnë të pandehurit dhe mbrojtësit të tij shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të të pandehurit.

33. Neni 9 Paragrafi 1 (Barazia e palëve) i KPP-së thotë:

Nëse me këtë Kod nuk parashihet ndryshe, i pandehuri dhe prokurori i shtetit në procedurë penale kanë pozitë të barabartë.

²¹ NB: asnjë Paragraf 2 nuk ekziston

34. Neni 244, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 e obligon Prokurorin që, jo më vonë se nga ngritja e aktakuzës, të ia japë mbrojtjes informacionin mbi identifikimin e personave për të cilët prokurori i shtetit e di se posedojnë prova të pranueshme dhe shfajësuese ose informata lidhur me çështjen dhe çdo procesverbal të deklarimeve, të nënshkruar apo të panënshkruar nga personat e tillë për këtë çështje.
35. Për ta kuptuar plotësisht rëndësinë e neneve të KPP-së të përmendura më lart, dhe më konkretisht Nenin 244 të KPP-së, këto nene duhet të kuptohet në kontekstin e tyre të të drejtave kushtetuese e njerëzore. Parimi i gjyqimit të drejtë është dhënë në Nenin 31 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Për më tepër, me anë të Nenit 22 dhe 53 të Kushtetutës, Neni 6 i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (KEDNJ) zbatohet direkt, dhe do të interpretohet në përputhje me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GJEDNJ).
36. Parimet e zbatueshme për obligimin e zbulimit të provave për mbrojtjen në procedura penale, siç është kodifikuar në bazë të Nenit 244 të KPP-së, qenë përcaktuar nga Dhoma e Madhe e GJEDNJ-së në tri aktgjykime të lëshuara më 16 shkurt 2000.

Në rastin *Rowe dhe Davis v. Mbretërisë së Bashkuar*²², Gjykata e Strasburgut konstatoi një shkelje të Nenit 6 § 1, duke e konsideruar si më poshtë:

“60. Ky është një aspekt themelor i së drejtës për një gjykim të drejtë se procedurat penale, duke përfshirë edhe elementet e procedurave të tilla të cilat kanë të bëjnë me procedurën, duhet të jenë adversial dhe se duhet të ketë barazi mes palëve, ndërmjet prokurorisë dhe mbrojtjes. E drejta për një gjykim adversial nënkupton, në një çështje penale, që të dyja palëve, prokurorisë dhe mbrojtjes, duhet t'i jepet mundësia që të kenë njohuri dhe komente mbi vëzhgimet e paraqitura dhe provat e nxjerra nga pala tjetër (...) Përveç kësaj, Neni 6 § 1 kërkon (...) që autoritetet e prokurorisë të ia shpallin mbrojtjes të gjitha provat materiale në posedim që janë pro ose kundër të akuzuarit (...)

61. Megjithatë, (...) e drejta për zbulimin e provave përkatëse nuk është një e drejtë absolute. Në çfarëdo procedurë penale mund të ketë interesa konkurruese, të tilla si siguria kombëtare ose nevoja për të mbrojtur dëshmitarët nga rreziku i reprzaljes ose ruajtja e metodave sekrete policore të hetimit të krimit, të cilat duhet të peshohen kundrejt të drejtave të të akuzuarit... Në disa raste mund të jetë e nevojshme që të mbahen të fshehta dëshmi të caktuara nga mbrojtja në mënyrë që të ruhen të drejtat themelore të një personi tjetër, ose për të mbrojtur një interes të rëndësishëm publik. Megjithatë, vetëm këto masa që kufizojnë të drejtat e mbrojtjes të cilat janë të domosdoshme janë të lejuara sipas Nenit 6 § 1 ... Për më tepër, për të siguruar se i akuzuari merr një gjykim të drejtë, çdo vështirësi që i shkaktohet

²² *Rowe dhe Davis v. MB (UK)*, GJEDNJ [GC] 16 shkurt 2000, Apl Nr. 28901/95

mbrojtjes nga një kufizim në të drejtat e saja, duhet të balancohet në mënyrë të mjaftueshme me procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore(...)

62. Në rastet kur provat janë mbajtur nga mbrojtja për arsye të interesit publik, nuk është roli i kësaj gjykate për të vendosur nëse një jo-zbulim i tillë ka qenë apo nuk ka qenë i domosdoshëm, meqë, si një rregull e përgjithshme, i takon gjykatave vendore për të vlerësuar provat para tyre... në vend të kësaj, detyra e Gjykatës Evropiane është që të konstatojë nëse procedura e vendimmarrjes zbatohet në çdo rast në përputhje, aq sa është e mundur, me kërkesat e procedurave adversiale dhe barazisë së armëve dhe me masat mbrojtëse adekuate të inkuorporuar për të mbrojtur interesat e të akuzuarit.

63. Një procedurë ku vetë prokuroria bën përpjekje për të vlerësuar rëndësinë e informacionit të fshehur nga mbrojtja dhe e peshon këtë kundër interesit publik në mbajtjen në fshehtësi të informacionit, nuk mund të pajtohet me kërkesat e sipërpërmendura të Nenit 6 § 1.”

Gjykata Evropiane konkludon në paragrafin 66:

“Pra, si përfundim, dështimi i prokurorisë për të i paraqitur provat në fjalë para gjykatësit dhe për të e lejuar atë që të vendosë mbi çështjen e të zbuluarit të provave, i privon aplikuesit nga një gjykim i drejtë.”

37. Në rastet *Jasper v. Mbretërisë së Bashkuar* dhe *Fitt v. Mbretërisë së Bashkuar* nga ana tjetër, Gjykata e Strasburgut nuk gjen shkelje të Nenit 6 § 1. Në këto raste,

“Gjykata është e bindur se mbrojtja kanë qenë të informuar dhe u është lejuar që të paraqesin parashtrësia dhe të marrin pjesë në (...) procesin e vendimmarrjes aq sa ishte e mundur, pa ua treguar atyre materialin të cilin prokuroria ka kërkuar për ta mbajtur sekret për arsye të interesit publik. Fakti se nevoja për zbulim ishte gjatë gjithë kohës nën vlerësim nga gjyqtarët duke pasur parasysh një mbrojtje të mëtejshme të rëndësishme, pra, ishte detyra e saj për të monitoruar përgjatë tërë gjykimit në ishte e drejtë apo jo, mbajtja e provave në fshehtësi.”²³

38. Në rastin *Al-Khawaja dhe Tahery v. Mbretërisë së Bashkuar*²⁴, Dhoma e Madhe shqyrton sipas Nenit 6 pranueshmërinë në prova të deklaratave të dëshmitarëve që kanë munguar të cilat kanë qenë prova “ të vetme apo vendimtare” kundër të akuzuarve, dhe jep disa udhëzime për kuptimin e ‘faktorëve të kundër balancuar’:

“144. Tradicionalisht, gjatë shqyrtimit të ankesave sipas Nenit 6 § 1, Gjykata e ka kryer ekzaminimin e drejtësisë së përgjithshme të procedurës duke pasur parasysh faktorë të tillë si mënyrën në të cilën garancitë ligjore janë aplikuar, shkallën deri ku i janë dhënë

²³ *Jasper v. Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ [GC] 16 shkurt 2000, Apl. Nr. 27052/95, Par. 55-56 dhe *Fitt v. Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ [GC] 16 shkurt 2000, Apl. Nr. 29777/96, 48-49

²⁴ *Al-Khawaja dhe Tahery v. Mbretërisë së Bashkuar*, GJEDNJ [GC] 15 dhjetor 2011, Apl. Nr. 26766/05 dhe 22228/06, Par. 144-145

mundësitë procedurale mbrojtjes për të kundërshtuar të metat dhe mënyrën në të cilën procedurat si një tërësi janë kryer nga gjyqtari i procedurës paraprake (...).

145. Gjithashtu, në rastet që kanë të bëjnë me mbajtjen në fshehtësi të provave nga mbrojtja, në mënyrë për të mbrojtur burimet policore, Gjykata ia ka lënë gjykatave vendore për të vendosur nëse të drejtat e mbrojtjes duhet të hiqen për interesin publik dhe e ka kufizuar veten për të verifikuar nëse procedurat e ndjekura nga autoritetet gjyqësore, në mënyrë të mjaftueshme janë kundër-peshë ndaj kufizimeve të caktuara ndaj mbrojtjes me garancitë e duhura. Fakti që prova të caktuara nuk i janë dhënë në dispozicion mbrojtjes, nuk është konsideruar automatikisht se ka shpënë në shkeljen e Nenit 6§ 1 (...).

147. (...)Pyetja në çdo rast është nëse ka faktorë të mjaftueshëm kundër-balancimi të vendosura, duke përfshirë edhe masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së atyre provave për të zërë vend. Kjo do të lejonte një bindje për të qenë e bazuar në prova të tilla vetëm nëse ajo është mjaft e besueshme duke pasur parasysh rëndësinë e saj për rastin.”

39. Edhe pse në *Al-Khawaja dhe Tahery vs. Mbretërisë së Bashkuar* nuk është përmendur në mënyrë të qartë, ajo është pranuar në rastin e fundit *Donohoe v. Irlandës*²⁵ se rregulla ‘e vetme apo vendimtare’ në mënyrë të barabartë zbatohet në rastet e mos-zbulimit. Dhoma e Gjykatës (pjesa e pestë), konstaton si në vijim.

“78. Gjykata vëren se rasti në fjalë nuk ka të bëjë me dëshminë e një dëshmitari anonim ose në mungesë. Ndryshe nga Al-Khawaja dhe Tahery, materiali në fjalë i pa zbuluar këtu, nuk formon në vete një formë të një pjese të rastit të prokurorisë.(...)Sidoqftë, gjykata vlerëson se në funksion të padrejtësisë së mundshme që mund të i jetë shkaktuar mbrojtjes nga gjykatat vendore, duke mbështetur kërkesën e privilegjit në lidhje me burimet e Shefit Kryesor të PK-së, ajo duhet që të udhëhiqet nga parimi i përgjithshëm i artikuluar nga Gjykata në rastin Al-Khawaja dhe Tahery, në shqyrtimin e ankesës ankuesit.

79. Prandaj, pyetjet që duhet të adresohen nga Gjykata janë të trefishta: (i) nëse ishte e nevojshme për të mbështetur pretendimin e privilegjit pohuar nga Shefi i PK-së në lidhje me burimin e besimit të tij; (ii) nëse është kështu, nëse provat e Shefit Kryesor të PK-së ishin baza e vetme apo vendimtare për dënimin e ankuesit; dhe, (iii) nëse ka qenë kështu, nëse ka pasur faktorë të mjaftueshëm kundër-balancimi, duke përfshirë ekzistencën e sigurisë procedurale, në mënyrë për të siguruar që procedurat, kur të gjykuara në tërësinë e tyre, ishin të drejta në kuptimin e Nenit 6 të Konventës..

Zbatimi i kriterëve të KEDNJ-së në rastin e tanishëm

40. Në rastin e tanishëm, informacioni se materiale relevante, duke përfshirë edhe ‘intervistat me dëshmitarët e mundshëm në këtë rast, intervistat me dëshmitarët aktual të emëruar në këtë rast

²⁵ *Donohoe v. Ireland*, GJEDNJ 12 dhjetor 2013, Apl. Nr. 19165/08

dhe materiale që kanë sugjeruar motivet e mundshme të dëshmitarëve për të dhënë dëshmi të rreme’, nuk i ishin dhënë mbrojtjes, ka ardhur nga Prokuroria. Për këtë arsye, Gjykata ka konstatuar se nuk mund të mbështetet në deklaratat e prokurorëve të mëvonshëm në këtë rast, të cilët thjesht kanë mohuar, pa dhënë arsyetim të mëtëjshëm, rëndësinë e materialit të pa-zbuluar. Gjykata, duke lëshuar disa urdhra, ka tentuar për të marrë të gjitha materialet përkatëse që ishin në posedim të Prokurorisë. Këto përpjekje kanë çuar në dorëzimin e CD-ROM-vë nga Prokuroria siq është përmendur më sipër, respektivisht nën numrat 19 dhe 22. CD-Rom-i që përmban dosjet ‘Ghost’ i është zbuluar mbrojtjes, por kjo mund të konkludohet nga vetë materiali që është i paplotë: referencë është bërë nga dëshmitarët për dokumentet të cilat nuk janë përfshirë. Tjetri CD-Rom, që përmban materialin e mbledhur gjatë hetimeve të vazhdueshme në rastin Hermes e deri në datën kur CD-Rom’i është dorëzuar në Gjykatë, pra 24 nëntor 2015, nuk ishte ndarë asnjëherë me mbrojtjen. Shqyrtimi i kujdesshëm i që të dyja CD-ROM ‘ve nga ana e Kryetarit të trupit gjykues ka treguar se hetimet Ghost/Hermes, si tërësi, janë të një interesi të konsiderueshëm për rastin në fjalë meqë ato në mënyrë të drejtpërdrejtë përfshijnë besueshmërinë e deklaratave të të dyshuarve të atëhershëm e që tani janë dëshmitarët kyq B.H. dhe SH.Q. në lidhje me integritetin e procedurave të gjykatës, *Inter Alia* RASHBBK1 Për më tepër, disa deklarata, të cituara (në formë të redaktuar)²⁶ si më lartë nën pikën 22, janë veçanërisht interesante, pasi që ato mund të i japin arsye mbrojtjes të argumentojnë se dëshmitarët, duke dëshmuar, po u shërbenin interesave të tyre, dhe se po merrnin udhëzime nga Prokurori. Nga kjo del se refuzimi i Prokurorit që ta ndajë këtë material me mbrojtjen shkakton një padrejtësi të mundshme, pasi që atyre u mohohet mundësia që ta përdorin atë material për të vënë në dyshim dëshmitarët. Si pasojë, ata janë vënë në një pozitë të ngjashme me atë të mbrojtjes në rastin *Donohoe v. Irlandës* të dhënë më sipër, i cili nuk ka mundur siq duhet që të sfidojë provat e dhëna nga Shefi Kryesor i PK-së nëpërmjet burimeve e tija të besueshme.

41. Për këtë arsye, në përputhje me jurisprudencën e GJEDNJ-së të përmendur më lartë dhe sistemit të propozuar nga seksioni i saj i pestë në rastin Donohoe, Gjykata do të përgjigjet në pyetjet si më poshtë: (i) a është e nevojshme për të respektuar vendimin e Prokurorit të mos zbulohen prova relevante për të vënë në dyshim dëshmitarët B.H. dhe Sh.Q.; (ii) nëse po, a pritet që dëshmitë (që do të) dhëna nga dëshmitarët B.H. dhe SH.Q., të jenë baze e vetme apo vendimtare për dënimin e të pandehurve, (iii) nëse janë, a mund të ofrojë Gjykata faktorë të mjaftueshme kundër-balancimi , duke përfshirë masat që lejojnë një vlerësim të drejtë dhe të duhur të besueshmërisë së provave,

²⁶ Duke pasur parasysh rrezikun e aluduar nga Prokurori

për të siguruar që procedurat, kur gjykuar në tërësinë e tyre, janë të drejta në kuptimin e Nenit 6 të Konventës Evropiane.

i Domosdoshmëria për të respektuar vendimin e mos zbulimit

42. Siç është konsideruar më parë nën pikën 40, sipas pikëpamjes së Gjykatës, një zbulimi i plotë pa dyshim do të ishte në interes të mbrojtjes. Megjithatë, sipas letrës së Prokurorit të datës 21 prill 2016, cituar më lart nën pikën 27, ka gjasa reale se zbulimi i këtyre materialeve dëshmuase do të rrezikojë qëllimin e hetimit dhe madje edhe jetën dhe shëndetin e njerëzve. Edhe pse rreziku i aluduar nuk është i qartë në shikim të parë, Gjykata nuk mund dhe nuk do të marrë përsipër rrezikun se zbulimi vërtetë do të rrezikojnë shëndetin ose jetën e njerëzve të përfshirë në hetimet Hermes. Prandaj, vendimi i mos-zbulimit në këtë rast duhet pra të merret si një *fait accompli*, dhe jo si rezultat i një balancimi të interesave nga ana e Gjykatës.

ii Të vetme apo vendimtare

43. Është përmendur në mënyrë eksplicite nga Prokurorja Bamieh në aktvendimin e saj për zgjerimin e hetimeve të cituar më lart nën pikën 10, dhe në fakt asnjëherë nuk është vënë në pikëpyetje nga ana e prokurorëve që kanë ardhur më pas, se dyshimi ndaj të pandehurve lind "kryesisht" nga deklaratat e B.H.t dhe SH.Q. Deklaratat e tyre mund të, siç theksohet në aktakuzë, jo vetëm që mbështesin njëra-tjetrën, por gjithashtu edhe të mbështeten nga prova materiale, por në këtë kontekst është e rëndësishme të kuptohet se sipas deklaratës së Sh.Q.²⁷ (por në kundërshtim me atë që është përmendur në aktakuzë!²⁸) dëshmitarët B.H. dhe SH.Q. kanë ndarë të njëjtën qeli në burg që në fillim të vitit 2011, dhe kishin qasje në, dhe njohuri të detajuara për dosjen e lëndës (siç u bë e qartë nga dëshmitë e tyre gjatë shqyrtimit gjyqësor para trupit gjykues²⁹), e cila u dha atyre mundësi të mjaftueshme për të bërë rregullimin e dëshmimeve të tyre dhe të ia përshtatin ato materialit ekzistues të provave. Nuk ka dyshim se një dënim eventual i të pandehurve do të bazohet, së paku në një masë vendimtare, në dëshmitë (që do të) e dhëna nga këta dy dëshmitarë. Kjo e shpije Gjykatën në përfundimin se dëshmitë e tyre duhet që të konsiderohen si dëshmi 'të vetme apo vendimtare' brenda kuptimit të jurisprudencës së GJEDNJ-së.

²⁷ Deklarata e Sh.Q. me datë 30 qershor 2011, e cituar më lartë nën pikën 7

²⁸ Aktakuza e datës 22 Gusht 2014, par. 90, e cituar më lartë nën pikën 14

²⁹ Procesverbal nga shqyrtimi kryesor i datës 26 dhe 27 gusht, 2, 3, 4 dhe 23, 24 dhe 25 shtator 2014

iii Faktorët kundër balancues

44. Për faktin se mbrojtja nuk është e pajisur me të gjitha provat që rezultuan nga hetimet në rastin Ghost/ Hermes, Gjykata nuk mund të ofrojë ndonjë faktor kundër balancimi. Dosja e Rastit Hermes ashtu siç i ishte dorëzuar Gjykatës mund të ketë qenë e kompletuar në momentin e dorëzimit të saj, por hetimet janë në vazhdim e sipër, dhe asnjë material i ri nuk është dorëzuar, dhe në funksion të qëndrimit të prokurorit aktual se nuk ka asnjë material për të zbuluar, nuk ka të ngjarë që ndonjë material i ri do të dorëzohet. Mohimi nga Prokurori aktual i ekzistencës së ndonjë prove shfajësuese, ose të ndonjë materiali, relevante për vlerësimin e kredibilitetit të dëshmitarëve, të kombinuara me mesazhin e Prokurorit në rastin Hermes se zbulimi i plotë ose i redaktuar do të rrezikonte shëndetin ose jetën e njerëzve të përfshirë, e ka sjellë Gjykatën në një pozitë që nuk mund të ia sigurojë mbrojtjes ndonjë faktor kundër balancimi. Sigurisht, B.H. dhe SH.Q. mund të dëgjohen, dhe në të vërtetë janë marrë në pyetje gjatë shqyrtimit gjyqësor para Trupit Gjyqësor të mëparshëm, në lidhje me qëndrimin e tyre jashtëzakonisht bashkëpunues. Megjithatë, përgjigjet ishin të paqarta, dhe nga mungesa e materialit me të cilën ata do të përballëshin, arsye të mundshme themelore mbeten të panjohura. Gjykata konkludon se nuk ka faktorë të kundër balancimit, duke përfshirë edhe masat mbrojtëse të forta procedurale, të vendosura për të siguruar që gjykimi, gjykuar si një tërësi, do të mund të jetë i drejtë në kuptim të Nenit 6 të Konventës.

Përfundimi

45. Siç përcaktohet më sipër, prokurori nuk ia ka ofruar mbrojtjes të gjitha materialet shfajësuese. Kështu që, ai nuk e ka përmbushur detyrimin e tij të përcaktuar në Nenin 244 të KPP-së, kuptuar në kontekstin e tij për të drejtat e njeriut dhe ato kushtetuese. Në qoftë se këto procedura do të vazhdonin pa materialin e pazbuluar, kjo mospërputhje në mënyrë të pashmangshme do të çojë në një shkelje të parimit adversial dhe barazisë së palëve të dhënë në Nenin 6 § 1 të Konventës Evropiane, sepse (i) Gjykata duhet ta marrë si një fakt vendimin e Prokurorit për të mos e zbuluar materialin e dosjes Hermes, relevante për fajësimin e dëshmitarëve (ii) deklarata e të cilëve do të jetë *prova e vetme apo vendimtare* për një dënim të mundshëm të të pandehurve, dhe (iii) Gjykata nuk mund të sigurojë faktorë kundër-balancues, duke përfshirë edhe ekzistimin e sigurive të forta procedurale, për të siguruar se gjykimi në tërësi megjithatë do të jetë i drejtë në kuptim të Nenit 6 të Konventës Evropiane.

46. Fakti që një vazhdim i këtij gjykimi mund të shpije në shkeljen e parimit të gjykimit të drejtë, është pa dyshim një "rrethanë që e përjashton ndjekjen penale" brenda kuptimit të Nenit 363,

paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 i KPP-së, që e bën të pashmangshme refuzimin e akuzave si në dispozitiv.

Kryetare e trupit gjykues
Gjyqtarja e EULEX-it Katrien Gabriël Witteman

Procesmbajtësi
Kushtrim Osmani

KËSHILLË LIGJORE: Në bazë të Nenit 380 të KPP-së, ankesa kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet brenda 15 ditësh nga dita kur kopja e aktgjykimit i është dorëzuar palëve. Ankesa duhet t'i drejtohet Gjykatës së Apelit përmes Gjykatës Themelore të Prishtinës.